

VOTA E DIASPORËS



RAPORT MONITORIMI

AUTOR
MARIO KOKONOZI

QENDRESA
QYTETARE



www.qeverisja.qq.com.al



Contents

Hyrje	3
Historia e Votimeve në Mungesë	4
Vota e Diaporës në vendin tonë	5
Vota e Diasporës në Kosovë	9
Shtysa për një Votë Diaspore	10
Gjetjet kryesore	13
Rekomandime	14
Bibliografia	15



Hyrje

Vota e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë të cilët jetojnë jashtë territorit shqiptar e të cilët nuk mund të votojnë dot në zgjedhje kombëtare vazhdon të mbetet një çështje e rëndësishme për të cilën ende nuk ka një zgjidhje. Mundësimi i votës për personat që jetojnë jashtë vendit është një domosdoshmëri e cila duhet të merret në konsideratë nga instancat e qeverisjes. Kjo çështje erdhi përsëri në vëmendje të opinionit publik më zgjedhjet kombëtare të 25 Prillit 2021. Debatet në muajt që paraprin datën e zgjedhjeve ishin të shumta, duke dhënë në opinion publik mendimin që kjo çështje do të zgjidhej dhe në 25 Prill qytetarët shqiptar në të gjithë botën do të kishin të drejtë të votonin. Kjo nuk ndodhi dhe ende sot dhe ky shqetësim vazhdon, duke lënë pezull shumë qytetarë të cilët nuk mund të votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Numërohet një numër i lartë i qytetarëve që zgjedhin të largohen nga Shqipëria për të gjetur një punë më të mirë apo për një cilësi jete më të lartë. Sipas një ankete nga INSTAT dhe sipas revistës Monitor, numërohen **360 mijë persona të cilët kanë emigruar vetëm në dekadën e fundit nga Shqipëria**¹. Në 30 vitet e fundit numërohen **1.7 milion shqiptar të larguar**². Të gjithë këta qytetarë duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës dhe të bëhen pjesë e votimeve në rang kombëtar. Kjo e drejtë nuk i'u është dhënë qytetarëve dhe është shtyrë për shkak të mosdakortësisë dhe vullnetit politik.



Globalizimi i kohëve që jetojmë ka bërë të mundur lëvizjen e lirë të njerëzve në të gjithë botën, kjo ka shtuar gjithashtu edhe emigrimin e shumë qytetarëve të cilët largohen nga vendi i tyre. Ky fenomen ka shtuar vëmendjen e qeverive të ndryshme që të mundësojnë votimin në mungesë, të ashtëquajtur "**vota e diasporës**" të qytetarëve që punojnë jashtë vendit si refugjatë si dhe të trupave diplomatike e ushtarakë të cilët për shkak të detyrës ndodhen jashtë vendit.

¹<https://www.monitor.al/anketa-ne-dekaden-e-fundit-kane-emigruar-360-mije-persona-largohen-nga-vendi-gati-7-e-familjeve-rekord-tirana/>

²<http://www.panorama.com.al/kriza-demografike-okb-rreth-1-7-mln-shqiptare-jane-larguar-nga-vendi-ne-30-vitet-e-fundit/>



Historia e Votimeve në Mungesë



≈ 60 p.e.s

Duke shkuar pak në retrospektivë, votimet në mungesë kanë një histori të gjerë e cila daton që në **Romën e lashtë**. Perandori August ishte ai që detyroi të gjithë anëtarët e Senatit që ishin shpërndarë në 28 kolonitë e perandorisë të votonin për kandidatët e zyrave në Romë. Votat e tyre vinin të vulosura dhe hapeshin ditën e zgjedhjeve. Më pas në shekullin 19-të, në **1862** në shtetin e Winskonsin ushtarët që luftonin në

Luftën Civile në **Shtetet e Bashkuara të Amerikës**, kishin mundësi të votonin për të zgjedhur drejtuesit e tyre në "shtëpi". Përtej kontekstit ushtarak që prevalon dhe gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, **Zelanda e Re** në vitin **1890** i dha mundësinë marinarëve dhe detarëve të tjerë të votonin në mungesë, **Australia** e ndoqi këtë procedurë në **1902**³.



1862



1890

Gjatë Luftës së Parë Botërore, **Mbretëria e Bashkuar**, duke parë që numri i njerëzve të cilët ishin në front ishte i madh, prezantoi në **1918**, votimin në mungesë.

Lufta e Dytë Botërore solli një nevojë më të lartë për votim në mungesë. Kjo erdhi sepse shumë persona ishin pjesë e trupave ushtarake, mjeksore dhe diplomatike. Në këtë kohë u përhap shumë votimi me postë, ku Kanadaja lejonte edhe të burgosurit e tyre të luftës të votonin në vendet e tyre respektive. Në **1945**, **Britania e Madhe lejoi votimin me postë** për të gjitha kategoritë e qytetarëve të cilit ishin jashtë vendit, duke i dhënë 3 javë kohë të votonin para datës së zgjedhjeve. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë patur votimin në mungesë të trupave ushtarake për një kohë të gjatë por lejimi i çdo kategori jashtë vendit erdhi në vitin 1975 mbas një presioni politik dhe social nga diaspora e kohës. Kjo datë është pak e vonë, krahasuar me vende të tjera perëndimore.

1902



1916

Në rastin e **Kanadasë**, ku në **1916** ushtarët jashtë vendit që kishin të drejtë të votonin, votuan në dy referendum, një mbi lejimin e grave për të votuar⁴, që kaloi pa probleme dhe ai i ndalimit të alkolit. Votimet për këtë referendum ishin shumë afër dhe vota e diasporës bëri diferencën për të mos lejuar ndalimin e alkolit. Mbështetësit e ndalimit të alkolit argumentuan se votat e diasporës ishin të fabrikuara dhe me probleme, një komision ligjor u ngrit dhe shpalli votat e diasporës të pavlefshme, duke bërë të mundur ndalimin e alkolit për shtetin e Kanadasë. Në **Argjentinë në 1993**, votimi i

³<https://www.idea.int/sites/default/files/publications/voting-from-abroad-the-international-idea-handbook.pdf> fq-41

⁴<https://www.thecanadianencyclopedia.ca/en/article/franchise>




1918



diasporës u lejua për të lidhur më shumë emigrantët me vendlindjen e tyre, në **Austri në 1990**, erdhi si shkak i njërezolute në Gjykatën Kushtetuese. Në **1975 Franca** lejoi votimin individual në ambasada dhe konsullata për zgjedhjet presidenciale dhe referendumet.

Konteksti social, historik dhe politik i vendit ka treguar që ka shumë rëndësi në mundësimin e diasporës për të votuar. Si dhe raste kur diaspora ka qënë ajo që ka bërë ndryshimin. Historia na tregon që vetë politikanët, pra ligjvënësit mund të jenë pikë kyçe në zbatimin e votimit në mungesë, informacion i cili është edhe shumë i rëndësishëm për kontekstin shqiptar, në kapitujt e tjerë të këtij shkrimi. Përsëri në Britaninë e Madhe në vitet 80', konservatorët, të cilët ishin në pushtet panë një mundësi të artë në sytë e tyre për ti dhënë mundësi qytetarëve të cilët ishin jashtë vendit, për të votuar. Shpresa e tyre ishte se ata mendonin që do të kishin një mbështetje të madhe nga diaspora. Ata mbetën të zhgënjyer nga numri i ulët i votuesve që u regjistruan përtej ishullit britanik. Edhe mbasi ata e hapën më shumë kuotën e diasporës që mund të votonin, duke e rritur nga 5 vjet në emigrim në 25 vjet, përsëri partia e tyre nuk mori ndonjë benefit të madh⁵.



Historia na tregon që vetë politikanët, pra ligjvënësit mund të jenë pikë kyçe në zbatimin e votimit në mungesë.



Vota e Diaporës në vendin tonë

Në vendit tonë çështja e votës në mungesë, e ashtëquajtur e emigrantëve është një histori e vjetër dhe e përsëritur. Ajo ka qënë pjesë e fjalimeve dhe fushtatave politike për një kohë të gjatë. Vota në mungesë, e atyre që nuk ndodhen fizikisht brenda territorit të Shqipërisë thjesht u risoll përsëri në opinionin publik me zgjedhjet e 25 Prillit 2021, **por ky diskutim ka qënë prezent në çdo datë zgjedhesh. Ish-kryeministri Sali Berisha e ka përmendur këtë çështje që në vitin 2012**, ku ai shprehej se duhej garantuar vota e emigrantëve⁶. Komunikimi dhe retorika politike e kohës ka qënë e një natyre tjetër dhe ato shkonin në një rugëtim ndryshe nga ajo që jemi mësuar të shohim sot, duke iu



⁵<https://www.idea.int/sites/default/files/publications/voting-from-abroad-the-international-idea-handbook.pdf>
fq-44

⁶<http://www.panorama.com.al/berisha-te-garantohet-vota-e-emigranteve/>

kërkuar qytetarëve jashtë vendit të ktheheshin në Shqipëri për të votuar sepse vota e tyre ishte vendimtare për fatin e zgjedhjeve⁷. Një realitet krejt tjetër, ku politikanët ishin më të investuar ti bënë thirrje diasporës të kthehej dhe të votonte dhe jo të reflektohej në mënyrë të ndryshme sesi vota e diasporës mund të bëhej realitet dhe qytetarët të votonin nga vendet ku ata ishin. Siç u evidentua edhe më lartë në rastin e Mbretërisë së Bashkuar në vitet 80', ku një parti e bëri realitet votën e diasporës **vetëm sepse besonte se ajo të votonte për partinë e tyre**. E njehta mënyrë e të menduarit vihet në jetë edhe nga **Edi Rama për zgjedhjet e 2013**. Duke parë që qeveria Berisha kishte dy mandate që drejtonte vendin, partia socialiste mendonte që qytetarët si brenda dhe jashtë vendit ishin të pakënaqur, andaj ai bënte thirrje ndaj diasporës që të vinte në Shqipëri për të votuar.



Qasja ndaj votës së diasporës dukej sikur po ndryshonte dhe realizimi i saj ishte pranë dhe **në 2016 eksponentë të lartë të qeverisë aktuale, si Taulant Balla, shpreheshin për mënyrat e votimit të qytetarëve jashtë shtetit në zgjedhjet kombëtare të vitit 2017**, ku propozohej dhe mënyra teknike e të votuarit. Votuesit jashtë shtetit duhet të regjistroheshin nga Qendra e Votimit në Shqipëri dhe të regjistroheshin në një listë të posaçme për ata që do të votonin nga jashtë vendit me postë⁸. Edhe në zgjedhjet e vitit 2017 vota e diasporës përsëri nuk u bë realitet.

Me fillimin e mandatit të dytë të qeverisë Rama u krijua dhe ministria e Diasporës. Ajo do të ishte pika e kontaktit me diasporën nëpër botë dhe një nga objektivat e saj ishte mundësimi i votës së diasporës dhe afrimi i diasporës me vendin tonë. Kjo ministri do të kryente një rol parësor në çështjen e votës së diasporës dhe do të ishte ajo që do të kalonte gjithë hapët që ky proces të merrte jetë. Ministria botoi **Strategji Kombëtare**⁹ si dhe ndërmori hapa lidhur me anën teknike, solli rekomandime dhe një material për Komisionin e Reformës Zgjedhore ku parashtroheshin argumentat, logjistika e votimit në distancë, kuadri ligjor, procedurat e votuesëve dhe shumë informacione të tjera të cilat do të ndihmonin deputët për të votuar aktet e sjella nga KQZ¹⁰.



⁷<http://www.panorama.com.al/rama-vota-e-emigranteve-vendimtare-me-23-qershor/>

⁸<http://www.panorama.com.al/propozimi-i-ps-ja-si-do-te-mundesohet-vota-e-emigranteve-ne-2017-n/>

⁹<http://akd.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/STRATEGJIA-KOMBETARE-E-DIASPORES-2021-2025.pdf>

¹⁰<http://akd.gov.al/wp-content/uploads/2021/09/VOTIMI-I-SHTETASVE-TE-REPUBLIKES-SE-SHQIPERISE-JASHTE-VENDIT.pdf>

Ministria e Shtetit për Diasporën ndërmori dy Samite të cilat ndër të tjera nxirrnin në pah edhe bërjen realitet të kësaj të drejtë për qytetarët shqiptarë jashtë Shqipërisë.

Kryeministri Rama, tha qartazi që në Samitin e Dytë të Diasporës, duke i thënë përfaqësuesve të diasporës shqiptare që *“ju siguroj se për votën tuaj, ka vetëm dy rrugë për ne: “O do ta bëjmë, o do ta bëjmë... Unë uroj që ta bëjmë të gjithë së bashku me konsensus. Nëse nuk do ketë konsensus, do ta bëjmë edhe pa konsensus”*¹¹ **Një premtim ky jo i mbajtur nga qeveria.** Ajo që u vu re nga ky samit i dytë ishte edhe mosdakortësia dhe shprehja e pakënaqësisë nga diaspora shqiptare, të cilët u shprehën të zhgënjyer nga samiti i parë dhe nuk panë asnjë rezultat konkret as nga i dyti, shprehur dhe në këtë shkrim të Deutsche Welle¹².

“ju siguroj se për votën tuaj, ka vetëm dy rrugë për ne: “O do ta bëjmë, o do ta bëjmë... Unë uroj që ta bëjmë të gjithë së bashku me konsensus. Nëse nuk do ketë konsensus, do ta bëjmë edhe pa konsensus”



Qeveria krijoi Këshillin Koordinues të Diasporës¹³ i cili do të shërbejë si urë lidhëse e shtetit shqiptar me diasporën, kultivimin e kulturës shqiptare nëpër botë, duke patur disa detyra të paracaktuara si dhe organizim të brendshëm të pavarur nga politika, mbledhja e parë e të cilit u mbajt më 18 Dhjetor 2019¹⁴.

Nga ana tjetër, qeveria krijoi një grup ndërinstitucional pune për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky grup pune u krijua në vitin 2019 duke përfshirë 6 ministri me portofol, Institutin e Statistikave dhe Ministrin e Shtetit për Diasporën¹⁵.

¹¹<https://gazetamapo.al/vota-e-diaspores-rama-do-e-bejme-edhe-pa-konsensusin-e-opozites/>

¹²<https://www.dw.com/sq/samiti-i-dyt%C3%AB-i-diaspor%C3%ABs-p%C3%ABrpjekje-serioze-apo-fasad%C3%AB-n%C3%AB-retorik%C3%ABn-e-radh%C3%ABs/a-47734003>

¹³<http://keshilli.koordinues.diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2019/05/VENDIM-Nr.340-PER-PERCAKTIMIN-E-RREGULLAVE-TE-HOLLESISHME-PER-KUSHTET-DHE-MENYREN-E-ZGJEDHJES-SE-PERFAQESUESVE-TE-KESHILLIT-KOORDINUES-TE-DIAS-1.pdf>

¹⁴<http://keshilli.koordinues.diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Revista-e-mbledhjes-s%C3%AB-K%C3%ABshillit-Koordinues-t%C3%AB-Diaspor%C3%ABs-2-1.pdf>

¹⁵<http://diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/URDH%C3%8BR-P%C3%8BR-NGRITJEN-E-GRUPIT-ND%C3%8BRINSTITUCIONAL-T%C3%8BPUN%C3%8BS-P%C3%8BR-HARTIMIN-E-PAKET%C3%8BS-LIGJORE-P%C3%8BR-GARANTIMIN-E-T%C3%8BDREJT%C3%8BS-S%C3%8BVOT%C3%8BS-P%C3%8BR-SHTETASIT-SHQIPTAR%C3%8BJASHT%C3%8BTERRITORIT-T%C3%8B-REPUBLIK%C3%8BS-S%C3%8BSHQIP%C3%8BRIS%C3%8B-1.pdf>

Në një mbledhje të kryeministrit me Këshillin Koordinues të Diasporës, u bë me dije që votat e diaporës do të numëroheshin në qarkun e Tiranës dhe votimi do të kryhej me postë. Nga ana tjetër u bë me dije që regjistrimi i qytetarëve potencialisht mund të bëhej elektronikisht por jo votimi¹⁶. Kryeministri shprehu gjithashtu që garantimi i votës së diasporës është një angazhim programor¹⁷ dhe duhet një dakortësi tre palëshe për këtë vendim për diasporën.

Me kalimin e kohën, reforma zgjedhore u soll në Kuvend për tu miratuar, një ndryshim që u pa në lidhje me votën e diasporës ishte fakti që ata nuk do të votonin vetëm për qarkun e Tiranës, si dhe nga ministri i diasporës Pandeli Majko u bë e qartë që zgjedhësit mund të votonin edhe pa regjistruar adresat e tyre në vendet respektive.



Ajo ç'ka ndodhi më vonë ishte dhe ajo që DPSHL konstatoi, që **“topi iu ngeç” Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**, të cilët duhet të nxirrin të gjitha aktet nënligjore lidhur me votën e diasporës, në një kohë rekord. Pikërisht në KQZ filluan dhe përplasjet e para politike, ku qeveria akuzonte Partinë Demokratike se anëtarët e saj në KQZ nuk po i miratojnë aktet nënligjore, duke sjell vonesa¹⁸. Kjo **solli dhe një luftë në distancë midis mazhorancës dhe opozitës duke hedhur akuza mbi njëra tjetrën** mbi fajin e dështimit të votës së diasporës. Ajo që u vu re më pas, ishte dhe mos reagimi i palëve politike mbi aktet nënligjore të cilat publikoi KQZ-ja. DPSHL bëri thirrje dhe dërgoi letra të hapura partive politike që të reagonin dhe të miratonin aktet nënligjore por ishte shumë vonë që ato të viheshin në zbatim. Duke sjell dhe një herë dështimin e votës së diasporës për qytetarët shqiptar.

Fajin nuk e pranon asnjëra palë, partitë politike nuk e dhanë dakortësinë e tyre për arsye të votave të “tyre”, të qytetarëve. Sipas opozitës, procesi do të minohej nga mazhoranca e cila ka në dorë të gjitha pushtetet, duke argumentuar dhe faktin që drejtori i postës shqiptare, është një pozicion politik dhe se gjithsesi ky ishte një dështim i Edi Ramës, i cili kishte 8 vjet në dispozicion për ta sjell votën e diasporës. Nga ana tjetër, partia socialiste nuk “i njeh” këto vota, pra nuk është e sigurtë në

¹⁶<https://euronews.al/al/vendi/2020/06/23/perllogaritja-e-votes-se-emigranteve-do-behet-vetem-per-listen-e-kryeqytetit/>

¹⁷<https://kryeministria.al/newsroom/me-keshillin-koordinues-te-diaspores-per-votimin-e-emigranteve/>

¹⁸<https://diasporashqiptare.al/2021/04/01/vota-e-diaspores-majko-pergjigje-pd-seperfaqesuesit-tuaj-ne-kqz-nuk-e-miratuan/>

qoftë se diaspora do të votojë në masë për ata, pa u marr drita jeshile që votat e diasporës janë në një përqindje të lartë për ata, nuk ka ndonjë interes për ta bërë realitet këtë gjë. Arsye tjetër është edhe fakti që vota e diasporës do të jetë e lartë mbas një fare kohe dhe ajo do të ketë një peshë të kosiderueshme për fatin e zgjedhjeve, siç ndodhi në zgjedhjet e Kosovës, ku **qeveria Kurti u përzgjedh vetëm mbas votës së diasporës**¹⁹. Ilirjan Celibashi nga KQZ gjithashtu u shprehet që nuk pati kohë të mjaftueshme dhe se **“përgjegjësia është e të gjithëve”**.

Me marrjen e mandatit të ri të qeverisë Rama, ministria e Diasporës nuk ishte më, duke hedhur hije dyshime mbi rolin e saj dhe gjithë shpenzimet që u kryen për të sjellë në jetë, konferenca, samite dhe udhëtime të cilat nuk shërbyen për asnjë gjë thelbësore në këtë proces. **Duke u prezantuar qeveria e re, ministria e diasporës nuk ishte më pjesë duke mos dhënë asnjë shpjegim apo detaj mbi arsyet e mbylljes së saj.** Florian Hackaj nga “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” shprehet që ky vendim erdhi vetëm për “ti mbyllur gojën diasporës dhe për të mos patur asnjë vend dhe portë konkrete për të kërkuar llogari mbi këtë çështje, ende sot nuk dihet se cilës ministri është përgjegjëse direkte për çështjet e diasporës”²⁰



Vota e Diasporës në Kosovë

Republika e Kosovës e ushtron të drejtën kushtetuese të votuarit në mungesë, pra nga jashtë vendit. Në zgjedhjet e fundit kombëtare ishin votat e diasporës ato që vulosën fatin e zgjedhjeve për qeverinë e Vetëvendosjes dhe ²¹. Kjo është edhe një


ndër arsyet kryesore se përse ky proces zvarritet në vendin tonë. Sistemi politik në Shqipëri është ende shumë i mbyllur dhe riciklimi i klasës politike ende nuk ka ndodhur. Vota e diasporës u trefishua në Kosovë nga zgjedhjet e fundit ku **votuan rreth 30,000 qytetarë duke e çuar numrin në 100.000** në zgjedhjet e Shkurtit 2021. Ky përsëri është një tregues që edhe në qoftë se fillon të funksionojë votimi i diasporës, impakti nuk do të jetë i menjëhershëm, duke lënë të kuptohet që ky proces do kërkoj kohën e tij edhe në Shqipëri.



¹⁹<http://www.panorama.com.al/vetevendosja-merr-kosoven-mund-te-qeverise-vetem-me-votat-e-diaspores/>

²⁰ Interviste me Florian Hackaj, bashkudrejtuës i Diaspora pwr Shqipwrinw e Lirw

²¹<http://www.panorama.com.al/vetevendosja-merr-kosoven-mund-te-qeverise-vetem-me-votat-e-diaspores/>



Në website-in e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë, shpjegohet shumë qartë mënyra dhe hapat që çdo qytetar duhet të ndjekë për të votuar. Hapat janë shumë mirë të shpjeguar dhe ato përmbajnë dokumente përkatëse dhe formularë aplikimi me anë të së cilave qytetarët vërtetojnë vendbanimin, adresën ku ndodhen, mjetet e identifikimit e të tjera. Në afat hapet për të gjitha ata që duan të votojnë që të dërgojnë kërkesat e tyre për votim. KQZ më pas verifikon vlefshmërinë e aplikimeve si dhe njofton qytetarët me anë të një telefonate. Votimi kryhet me anë të postës përpara datës së zgjedhjeve dhe më pas ato numërohen bashkë me votat e tjera, por si vota të diasporës²².



Shtyrsa për një Votë Diaspore

Një organizatë jo qeveritare e cila ka qënë promotor i votës së diasporës dhe një advokues shumë i fortë i saj është **Diaspora për Shqipërinë e Lirë**, e cila është një nismë qytetare e lindur jashtë Shqipërisë e cila angazhohet në mënyrë pro-aktive për përfshirjen e mërgatës shqiptare në proceset politike dhe ato politikbërëse brenda Shqipërisë²³. Me të drejtë, kauza e tyre e tanishme është tejet e rëndësishme për këtë grupim por edhe për të gjithë qytetarët.



Mundësimi i votës për një numër të madh shqiptarësh që jetojnë jashtë vendit është një e drejtë kushtetuese që lidhet me të drejtën e votës për çdo qytetar, **neni 45 i Kushtetutës së Shqipërisë**, si dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijëve të vet, **neni 8 i Kushtetutës**²⁴.

Organizata ka kryer një punë të qënësishme lidhur me votën e diasporës, pranë grupit të punës për votën e diasporës të ngritur brenda organizatës, duke ngritur zërin dhe duke punuar në mënyrë proaktive për të mundësuar votën e diasporës për qytetarët shqiptar. Organizata që ai bashkëdrejton ka ndjekur hapa të rëndësishëm,

²²<https://www.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/>

²³<https://www.diasporaofalbania.com/>

²⁴<https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf> fq 3, fq 11

duke kryer shumë takime me instancat e qeverisë me qëllim mundësimin e votës së diasporës. Kjo është shoqeruar dhe me ndërgjegjësim dhe informim publik, në dalje të ndryshme televizive në ekranet më të mëdha të vendit. Edhe pse vota e diasporës nuk u arrit nga qeveria, përpjekjet vazhdojnë për ta mundësuar atë në zgjedhjet e ardhshme të vitit 2025.

Shtypa e vet diasporës në këtë nismë ishte një motor i cili mund të përshpejtonte arritjen e votës së diasporës andaj dhe DPSHL ndjeu detyrën për të qënë pjesë e tryezave përball aktorëve lokal dhe ndërkombëtarë, për të kërkuar llogari, si dhe për të ofruar asistencën e tyre profesionale në të gjitha pikat kyçe të këtij procesi të gjatë.

Ofrimi i varianteve të votimin në mungesë përfshinin votimin në konsullata dhe ambasada, votimin elektronik si dhe votimin me postë. Votimi në ambasada mbetet më pak i dëshiruar për shkak të disa faktorëve si nepotizmi nëpër ambasadat dhe konsullatat e vendit tonë, mungesa e kapacitetit të duhura njerëzore si dhe largësinë e këtyre institucioneve nga votuesit, ambasadat shpesh janë të vendosura nëpër kryeqytete. Eksperienca ka treguar që një presion i jashtëm, qoftë nga vet diaspora, qoftë nga institucione ndërkombëtare, për të sjell ndryshim, ka rezultuar produktive për të vënë në punë organet e qeverisë.



Drejtuesit e DPSHL, së bashku me organizata të tjera kanë kryer takime të njëpasnjëshme me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për të asistuar si dhe për të ofruar ndihmën e tyre si monitories të procesit të numërimit të votës së diasporës.

Ajo që vihej re ishte angazhimi dhe vullneti i shprehur nga KQZ dhe kryetari i saj, Komisionerit Zgjedhor Ilirjan Celibashi, për të ecur përpara dhe për ta bërë realitet votën e diasporës nga ana teknike²⁵. Dhënia e mundësisë, pra lejimi i qytetarëve që jetojnë jashtë të regjistrohen për të votuar në shtetet përkatëse solli dhe reagimin e diasporës ndaj institucioneve shqiptare, ku ata ankoheshin për zgjatjen e shumtë të procedurave burokratike për ribërjen e dokumentave të identifikimit, në përgjithësi, pranë konsullatave dhe ambasadave të shtetit tonë. DPSHL ndoqi rrugë dhe kanale pro-aktive duke e sjell këtë shqetësim pranë institucioneve si Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke kërkuar informacion mbi këto çështje²⁶.

Ajo që u kuptua nga DPSHL dhe që u reflektua me një deklaratë nga një drejtues i saj ishte kjo *"I gjithë diskutimi teknik i votës së diasporës varet nga vullneti politik. Nëse*

²⁵<https://www.facebook.com/diasporaofalbania/photos/a.675374139162716/4058097750890321/>

²⁶<https://www.facebook.com/diasporaofalbania/posts/4106033359430093>

ky proces nuk do të hedhi hapin e parë drejt realizimit, atëherë kjo do të jetë fiasko e madhe e klasës politike shqiptare dhe mesazh negative ndaj Diasporës."²⁷

Kjo u reflektua gjatë mungesës së reagimit të subjekteve politike ndaj Projekt Aktit Normativ që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve publikoi lidhur me procedurat e regjistrimit të shtetasve shqiptarë me qëndrim jashtë shtetit si dhe për procesin e votimit të tyre nga vendet e banimit jashtë Republikës së Shqipërisë. Tre partitë më të mëdha në vend nuk patën ndonjë reagim zyrtar apo edhe thjesht komente mbi punën e ngritur nga KQZ, gjë që reflektoi vullnetin e dobët politik nga ligjvënësit shqiptar dhe partitë opozitare në kuvend. Kjo binte ndesh me premtimet publike nga ana e qeverisë dhe vet Kryeministrit Edi Rama, i cili ishte shprehur që vota e diasporës do të bëhej realitet me zgjedhjet e 25 Prillit. DPSHL në një komunikatë zyrtare iu drejtua këtyre partive duke i shtyrë të reagonin ndaj Akteve të KQZ-së²⁸. Reagim nuk pati dhe në mesin e muajt Shkurt **rreth 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve u kuptua që vota e diasporës nuk do të bëhej realitet dhe premtimet e politikanëve ishin premtime boshe.** Në një tjetër letër të hapur drejtuar liderëve të partive kryesore, KQZ-së dhe ministrit për Diasporën, DPSHL shprehu indinjatën e saj përsa i përket vendimarrjes së vonuar për Projekt Aktet e KQZ dhe mos miratimin e një numri aktesh të tjera lidhur me realizimin e votës së diasporës²⁹.



Drejtimesit e Diasporës për Shqipërinë e Lirë janë duke përgatitur një padi ligjore në gjykatën kushtetuese kundrejt shtetit shqiptar³⁰ lidhur me këtë të drejtë kushtetuese që ka çdo qytetar i vendit, qoftë brenda apo jashtë Shqipërisë. Kjo e drejtë nuk duhet të shtyhet më, dhe duhet të përgatitet e të testohet përpara zgjedhjeve të ardhshme, duke mos dhënë asnjë mundësi për ta shtyrë apo për të nxjerr justifikime³¹. Nga pikëpamja e DPSHL, **në vendin tonë ka një nevojë të lartë për të advokuar çështje në mënyrë qytetare me mjete demokratike**, të cilat nxjerrin në pah mungesën e vëmendjes ndaj atyre politikave të rëndësishme për jetën e çdo qytetari.

²⁷<https://www.facebook.com/diasporaofalbania/photos/a.675374139162716/4080098112023618/>

²⁸<https://www.facebook.com/diasporaofalbania/photos/a.675374139162716/4114403421926420/>

²⁹<https://www.facebook.com/diasporaofalbania/posts/4167472566619505>

³⁰ Intervistë me Florian Hackaj

³¹<https://www.facebook.com/diasporaofalbania/photos/a.675374139162716/4868301223203299/>



Gjetjet kryesore



Tentativat për mundësimin e votës së diasporës në vitin 2012 nga qeveria Berisha dhe në 2016 nga Qeveria Rama mbeten premtime të porealizuara në deklarata politikanësh. Partitë u investuan ti bëjnë thirrje diasporës të kthehet të votojë, jo ti mundësojnë votën nga vendi ku jetonin.



Qeveria Rama II krijoi Minsitrinë e Diasporës, si instrument për mundësimin e votës, ministri e cila organizoi dy samite të diasporës, miratoi një strategji dhe formoi një Këshill Koordinues të Diasporës, si urë lidhëse e shtetit shqiptar me diasporën. Produkti final i kësaj përpjekje ishte që në zgjedhjet e vitit 2021 vota e diasporës mbeti akt juridik në letër i pazbatuar.



Partitë Politike nuk reagueshan në kohë ndaj akteve nënligjore të përgatitura nga KQZ për votën e diasporës përpara zgjedhjeve të 25 prillit duke vijuar me mohimin e kësaj të drejtë ndaj këtij komuniteti.



Me marrjen e mandatit të ri, Qeveria Rama III, Ministria e Diasporës nuk ishte më duke mos dhënë asnjë shpjegim apo detaj mbi arsyet e mbylljes së saj dhe duke hedhur hije dyshimi mbi rolin e saj dhe gjithë shpenzimet që u kryen për të sjellë në jetë, konferenca, samite dhe udhëtime të cilat nuk shërbyen për asnjë gjë thelbësore në këtë proces.



Rekomandime



Votimi në mungesë, pra si brenda dhe jashtë vendit është një e drejtë kushtetuese e cila duhet ti garantohet qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.



Procesi i votës së diasporës duhet të depolitizohet në të gjitha hallkat e tij duke shmangur influencimin dhe vjedhjen e votes. Vullneti politik dhe gjetja e gjuhës së përbashkët midis partive politike është thelbësore për këtë proces.



Institucionet shqiptare duhet te krijojnë dhe të votojnë aktet nënligjore për votën e diasporës duke lehtësuar procesin afër datës së zgjedhjeve.



Studimi i modeleve të votës së diasporës në Rajon është një aset shumë i vyer për tu ndjekur dhe trajnimi i stafit të KQZ dhe strukturave të tjera mbështetëse mbi mënyrat e votimit në mungesë është i domosdoshëm.



Ndihma dhe përfshirja e diasporës në këtë proces duhet të kryhet për ti dhënë kredibilitet procesit si dhe afron diasporën më shumë me vendin dhe me vetë procesin e të votuarit në distancë.



Bibliografia

Courtney, C. A (2007) "Right to Vote in Canada" <https://www.thecanadianencyclopedia.ca/en/article/franchise> (Aksesuar, 26.12.21)

Diaspora për Shqipërinë e Lirë Eëbsite <https://www.diasporaofalbania.com/> (Aksesuar 07.01.2022)

Ellis, A. Navarro, C. Morales, I. Gratschew, M, Braun, N, (2007) "Voting from Abroad, The International IDEA Handbook", Federal Electoral Institute of Mexico, Mexico ISBN: 978-91-85391-66-0 <https://www.idea.int/sites/default/files/publications/voting-from-abroad-the-international-idea-handbook.pdf>

Euroneës Albania (2020) "Përlllogaritja e votës së emigrantëve do bëhet vetëm për listën e kryeqytetit" <https://euronews.al/al/vendi/2020/06/23/perlllogaritja-e-votes-se-emigranteve-do-behet-vetem-per-listen-e-kryeqytetit/> (Aksesuar, 15.01.2022)

Diaspora për Shqipërinë e Lirë (09.01.2021) Postim në Facebook <https://www.facebook.com/diasporaofalbania/photos/a.675374139162716/4058097750890321/> (Aksesuar, 09.01.2022)

Diaspora për Shqipërinë e Lirë (25.01.2021) Postim në Facebook <https://www.facebook.com/diasporaofalbania/posts/4106033359430093> (Aksesuar, 09.01.2022)

Diaspora për Shqipërinë e Lirë (16.01.2021) Postim në Facebook <https://www.facebook.com/diasporaofalbania/photos/a.675374139162716/4080098112023618/> (Aksesuar, 09.01.2022)

Diaspora për Shqipërinë e Lirë (28.01.2021) Postim në Facebook <https://www.facebook.com/diasporaofalbania/photos/a.675374139162716/4114403421926420> (Aksesuar, 09.01.2022)

Diaspora për Shqipërinë e Lirë (18.02.2021) Postim në Facebook <https://www.facebook.com/diasporaofalbania/posts/4167472566619505> (Aksesuar, 09.01.2022)

Diaspora për Shqipërinë e Lirë (07.10.2021) Postim në Facebook <https://www.facebook.com/diasporaofalbania/photos/a.675374139162716/4868301223203299/> (Aksesuar, 09.01.2022)

Diaspora Shqipëtare (2021) "Vota e Diasporës, Majko përgjigje PD-së: Përfaqësuesit tuaj në KQZ nuk e miratuan" <https://diasporashqiptare.al/2021/04/01/vota-e-diaspores-majko-pergjigje-pd-seperfaqesuesit-tuaj-ne-kqz-nuk-e-miratuan/>

Gazeta Mapo (2019) "Vota e Diasporës, Rama: Do e bëjmë realitet edhe pa konsensus" <https://gazetamapo.al/vota-e-diaspores-rama-do-e-bejme-edhe-pa-konsensusin-e-opozites/> (Aksesuar, 15.01.2022)

Hoxha B. (2020) "Anketa / Në dekadën e fundit kanë emigruar 360 mijë persona, largohen nga vendi gati 7% e familjeve (rekord Tirana)", Revista Monitor, <https://www.monitor.al/anketa-ne-dekaden-e-fundit-kane-emigruar-360-mije-persona-largohen-nga-vendi-gati-7-e-familjeve-rekord-tirana/> (Aksesuar, 30.12.2021)

Këshilli i Ministrave (2018) "Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Kushtet dhe Mënyrën e Zgjedhjes së Përfaqësuesve të Këshillit Kordinues të Diasporës" <http://keshilli.koordinues.diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2019/05/VENDIM-Nr.340-PER-PERCAKTIMIN-E-RREGULLAVE-TE-HOLLESISHME-PER-KUSHTET-DHE-MENYREN-E-ZGJEDHJES-SE-PERFAQESUESVE-TE-KESHILLIT-KOORDINUES-TE-DIAS-1.pdf>

Këshilli i Ministrave (2019) "Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Hartimin e Paketës Ligjore për Garantimin e të Drejtës së Votës për Shtetasit Shqiptarë Jashtë Territorit të Republikës së Shqipërisë" <http://diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/URDH%C3%8BR-P%C3%8BR-NGRITJEN-E-GRUPIT-ND%C3%8BRINSTITUCIONAL-T%C3%8B-PUN%C3%8BS-P%C3%8BR-HARTIMIN-E-PAKET%C3%8BS-LIGJORE-P%C3%8BR-GARANTIMIN-E-T%C3%8B-DREJT%C3%8BS-S%C3%8B-VOT%C3%8BS-P%C3%8BR-SHTETASIT-SHQIPTAR%C3%8B-JASHT%C3%8B-TERRITORIT-T%C3%8B-REPUBLIK%C3%8BS-S%C3%8B-SHQIP%C3%8BRIS%C3%8B-1.pdf>

Këshilli Kordinues i Diasporës (2019) "Mbledhja e Parë e Këshillit Kordinues të Diasporës" <http://keshilli.koordinues.diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Revista-e-mbledhjes-s%C3%AB-K%C3%ABshillit-Koordinues-t%C3%AB-Diaspor%C3%ABs-2-1.pdf>

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë <https://www.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/>

Kryeministria (2020) "Vota e Diasporës në Reformën Zgjedhore" <https://kryeministria.al/newsroom/me-keshillin-koordinues-te-diaspores-per-votimin-e-emigranteve/> (Aksesuar, 15.01.2022)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë <https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf>

Ministri i Shtetit për Diasporën (2018) "Votimi i Shtetasve të Republikës së Shqipërisë Jashtë Vendi për Komisionin e Reformës Zgjedhore në Kuvendin e Shqipërisë" <http://akd.gov.al/wp-content/uploads/2021/09/VOTIMI-I-SHTETASVE-TE-REPUBLIKES-SE-SHQIPERISE-JASHTE-VENDIT.pdf>

Ministri i Shtetit për Diasporës (2020) "Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqipëtare 2021-2025" <http://akd.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/STRATEGJIA-KOMBETARE-E-DIASPORES-2021-2025.pdf>

Panorama.al (2012) "Berisha: Të garantohet vota e emigrantëve" Gazeta Panorama 22 Gusht 2012 <http://www.panorama.com.al/berisha-te-garantohet-vota-e-emigranteve/> (Aksesuar, 12.01.22)

Panorama.al (2013) "Rama: Vota e emigrantëve, vendimtare në 23 Qershor" Gazeta Panorama 29 Prill 2013 <http://www.panorama.com.al/rama-vota-e-emigranteve-vendimtare-me-23-qershor/> (Aksesuar, 12.01.22)

Panorama.al (2016) "Propozimi i PS / Ja si do të mundësohet vota e emigrantëve në 2017" Gazeta Panorama 28 Shtator 2016 <http://www.panorama.com.al/propozimi-i-ps-ja-si-do-te-mundesohet-vota-e-emigranteve-ne-2017-n/> (Aksesuar, 12.01.22)

Panorama.al (2021) "Vetëvendosja "merr" Kosovën, mund të qeverisë vetëm me votat e diasporës" <http://www.panorama.com.al/vetevendosja-merr-kosoven-mund-te-qeverise-vetem-me-votat-e-diaspores/> (Aksesuar, 17.01.2022)

Panorama.al (2022) "Krizë Demografike/ OKB: Rreth 1.7 mln shqiptarë janë larguar nga vendi 30 vitet e fundit ", Gazeta Panorama 10 Janar 2022 <http://www.panorama.com.al/kriza-demografike-okb-rreth-1-7-mln-shqiptare-jane-larguar-nga-vendi-ne-30-vitet-e-fundit/> (Aksesuar, 10.01.2022)

Shuka, A. (2019) "Samiti i Dytë i Diasporës – Përpjekje serioze apo fasadë në retorikën e radhës" Deutsche Welle <https://www.dw.com/sq/samiti-i-dyt%C3%AB-i-diaspor%C3%ABs-p%C3%ABrpjekje-serioze-apo-fasad%C3%AB-n%C3%AB-retorik%C3%ABn-e-radh%C3%ABs/a-47734003>

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



www.qeverisja.qq.com.al

RAPORT

MINISTRINË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Shtator - Dhjetor 2021